

FESTO ME



DEMOKRACI

PA DEMOKRACI NUK KA DREJTËSI

NAZMIE (12), ERISA (12), MEDINA (12), RINESA (12), GENATA (12), HAJRIE (12), XHABIR (12),
ARTIOL (12), BLERON (12), ETNIK (13)


Shumë të dashur dhe të nderuar lexues, kjo është hera jonë e dytë që jemi duke shkruajtur artikull informues për të gjithë ju. Kësaj radhe, ne kemi mësuar për demokracinë, për të cilën do t'iu informojmë edhe juve në vazhdim



Këtu shokët dhe shoqet e mia kanë paraqitur disa fëmijë, të cilët janë shumë të lumtur falë të drejtave që ata i gëzojnë. Të lumtur si këta fëmijë, jemi edhe ne, sepse jetojmë në një vend ku respektohen të drejtat

Demokracia nuk është thjesht një fjalë, e cila gjendet në fjalorin e secilës gjuhë. Ajo është vetë jeta jonë. Ne si fëmijë çdo ditë e jetësojmë atë, por këtë nuk e bëjmë vetëm ne. „Nuk është e drejtë të thuani që vetëm fëmijët e jetësojnë demokracinë,“ tha Genata. Ajo nuk bën përjashtime e nuk njih dallime. Arsyeja pse mendoni kështu, ju të dashur shokë është se ndoshta jeni duke menduar se si ka qenë demokracia në të kaluarën, ku shumica e qytetarëve nuk trajtoheshin në mënyrë të barabartë. Edhe pse vetë kuptimi i fjalës demokraci do të thotë udhëheqje e popullit, asokohe, përkatësisht në shek. V-të p.e.s. si shumicë konsideroheshin vetëm qytetarët fisnik e të pasur. Ajo ishte demokraci shumë më e kufizuar nga kjo që ne sot e kemi. Nuk kishte as barazi, e as drejtësi. Mund të imagjinoni edhe vetë ju të dashur lexues, se si ka funksionuar demokracia në të kaluarën. Kur jemi te barazia, përsëri Genata ngriti dorën dhe tha se donte të ndante me ne një rast kur ajo nuk është ndjerë e ba-

rabartë me të tjerët. „Një ditë, një grup shokësh kishin bërë plane për të dalur në qytet pa mua. Kjo ishte një ndër ditët më të këqija që unë kisha përjetuar. Kërkova nga ata të më tregonin se pse e kishin bërë një veprim të tillë, por asnjëri prej tyre nuk u përgjigj. Të nesërmen, shokët dhe shoqet erdhën tek unë dhe duke më kërkuar falje, më premtuan se nuk kanë për ta bërë më atë veprim.“ Genata u kthye nga ne dhe tha: „Në demokraci ka edhe falje“. Pasi që jemi tek e kaluara, vlen të theksohet që në kohën kur është shfaqur demokracia, në shekullin e V-të para erës sonë, vendimet merreshin direkt nga ana e popullit. Pra, ishte demokraci e drejtpërdrejtë. Kurse, me kalimin e kohës dhe me rritjen e madhe të numrit të popullsisë, u pa e nevojshme që përpos demokracisë së drejtpërdrejtë, të vihet në funksion demokracia përfaqësuese. Ne mendojmë se të dyja janë të mira, por më shumë e preferojmë dhe e duam demokracinë përfaqësuese, atë të cilën vendi ynë e ka.



Demokracinë e ndërtojnë dhe për të kujdesen qytetarët aktiv. E ne jemi të fillë!

NE PUNOJMË PËR JU

ALBIN (12), ENSAR (12), ERON (12), BLEURITA (12), ARLIND (12)


Ne, deputetët e Kuvendit të Kosovës dëshirojmë t’iu tregojmë më shumë për punën tonë që e bëjmë në Kuvend. Lexoni edhe më tej, që të kuptoni më mirë rolin dhe përgjegjësitë e shumta që i kemi ne

Së pari, ne kandidojmë në zgjedhje parlamentare. Gjatë këtyre zgjedhjeve, ne tentojmë të fitojmë sa më shumë vota nga qytetarët e Kosovës. Pasi që t’i fitojmë votat, ne zyrtarisht marrim rolin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Në ditën e parë të punës, ne betohemi para të gjithë qytetarëve të Kosovës, si dhe para deputetëve të tjerë të rinj dhe themi: „Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të nje-

riut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!“

Puna jonë si deputetë vazhdon me zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, i cili udhëheq seancat tona plenare. Ne zgjedhim edhe Qeverinë, si dhe e mbikëqyrim punën e saj gjatë mandatit tonë 4 vjeçar. Kurse, çdo 5 vjet ne zgjedhim Presidentin e Republikës së Kosovës.

Gjithsej jemi 120 deputetë, të cilët kemi të drejta të barabarta dhe përgjegjësi të njëjta, sepse punojmë në institucionin më demokratik të vendit dhe iu përfaqësojmë të gjithë juve, pa asnjë dallim. Në radhët tona kemi edhe përfaqësues nga komunitetet jo shumicë dhe ky fakt na bën neve të jemi një ndër popujt më demokratik në botë. Ne jemi të vendosur t’iu mbrojmë dhe të punojmë për ju.




Vendi ku ne punojmë me nder dhe me përkushtim



Një deputete, duke u përgjigjuar për media



Gazetarët në rolin e deputetëve



Votat tona janë shumë të fuqishme

PËRFAQËSUESIT TANË NË KUVEND

ARNISA (12), BLERTA (13), ARDIANA (13), SEAD (12), BLERIM (13), MIRSAJ (12), DREN (12), YLLI (12),
FATMIRE (13), EMIRJONA (12)

Ligjet e miratuara në Kuvend i japin kahje jetës sonë si qytetarë


Mami dhe babi im, që të dy punojnë. Të dy prindërit e mi e ushtrojnë të njëjtin profesion, që është ai i arkitektit/es. Ndonëse në të kaluarën ka qenë shumë e rrallë që gratë të punojnë, sot kjo gjë nuk ka rëndësi. Në familjen time, por, besoj edhe në familjet tuaja lexues të dashur, punojnë si burrat, ashtu edhe gratë. Kjo tregon se nuk ndodhin diskriminime në bazë të gjinisë. Këtë na e sigurojnë ligjet, rregulla që sigurohen që të mos ndodhin diskriminime të asnjë lloji. Në Kosovë, ekziston ligji i punësimit, i cili thotë se të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, kanë të drejtë të punojnë. Kjo tregon sesa të mira janë ligjet dhe sesa shumë e rregullojnë jetën tonë. Ligj tjetër është edhe ligji i pensionit. Të gjithë qytetarët mbi moshën 65 vjeçare kanë të drejtë të kenë një pension. Ky fakt na gëzon shumë. Kjo sepse edhe kur të plakemi, do të kemi të ardhura, ndonëse nuk do të punojmë. A e shihni sa të mira janë ligjet? Këto ligje miratohen në Kuvend. Ky funksion njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër është ai kontrollues, sepse Kuvendi kontrollon punën e Qeverisë. Ndërkaq, funksioni i tretë është ai përfaqësues, sepse deputetët janë përfaqësuesit tanë në Kuvend.



Ne deputetët përfaqësojmë interesat e qytetarëve




Miratimi i ligjeve bëhet me vota



ZGJEDHJET NË KOSOVË

BEHARI (12), NJOMZA (12), LAURA (12), PRANVERA (12), ERONA (12)



Çfarë do të mësoni nga ky artikull? Në këtë artikull, besojmë se do të mësoni shumë gjëra rreth zgjedhjeve në Kosovë

Ne nxënësit, të cilët sot kemi marrë rolin e gazetarëve do të flasim për zgjedhjet. Por, çfarë janë ato? Zgjedhjet janë procesi shumë i njohur, përmes të cilit ne, qytetarët dalim dhe votojmë për kandidatët më të mirë. Dallojmë zgjedhjet komunale, të cilat ndryshe quhen edhe zgjedhje lokale. Kemi edhe zgjedhjet parlamentare apo qendrore. Në Kosovë për herë të parë, zgjedhjet lokale janë mbajtur në vitin 2000.



Kurse, zgjedhjet e para parlamentare janë mbajtur në vitin 2001. Për të dalur të votojmë duhet t'i kemi mbushur 18 vjet. Të gjithë qytetarët në një vend demokratik kanë të drejtë të shprehin mendimet e tyre lirshëm për ta votuar një kandidat për deputet. Në zgjedhjet parlamentare votojmë vetëm për deputetët. Ndërsa, në ato lokale dalim dhe zgjedhim kryetarin e komunës, bashkë me asamblistët komunal. Si forma të votimit kemi votimin e hapur dhe atë të mbyllur.

Votim i hapur është kur edhe personat e tjerë mund ta shohin votën tonë. Kurse, votim i mbyllur është kur votën tonë nuk e shikon askush.

Ju mund të thoni përse disa fëmijë po flasin për zgjedhje, kur ata nuk kanë akoma të drejtë të votojnë? Ne kemi vendosur të flasim për këtë temë, sepse ky proces është shumë i rëndësishëm për ne dhe për të ardhmen tonë. Por, gjithashtu, edhe ne kemi pasur rastin të votojmë. Ne në klasë kemi zgjedhur kryetarin e klasës, e po ashtu, edhe kapitenin/en e futbollit për vajza dhe për djem. Ky votim ishte votim i hapur, pasi që të gjithë e kemi parë votën tonë. Ne votuam me ngritjen e dorës. Në fund, personi që mori më shumë vota u zgjodh kapiten/e. Në rastin tonë, kapitene për vajza u zgjodh Bleurita, ndërsa për djem u zgjodh Ensari.

Shpresojmë që artikulli ynë t'iu ketë pëlqyer shumë, për shkak se ne punuam shumë për ta realizuar atë. Gjithashtu, shpresojmë se keni marrë shumë informata të reja për zgjedhjet.



Ne jemi ata të cilët punojmë për demokracinë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hitmi Rakovica“
Klasa: VII-1
Vendi: Prishtinë